



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.970/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi kryesues, Zyhdi Haziri dhe Kymete Kicaj anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatës për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës, Besa Prestreshi nga Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet pjesërisht i bazuar apeli Anr.970/2021, paraqitur nga Besa Prestreshi, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, për Venvotimin 1930-01D, në Komunën e Prishtinës.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal të Prishtinës, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratik e Kosovës, në Vendvotimin: 1930-01D.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në Vendvotim, të vendosura si në pikën **-II-** të këtij dispozitivi të këtij vendimi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

IV. Refuzohet e pabazuar pjesa tjetër e apelit Anr.970/202 lidhur me rinumërimin e fletëvotimeve në vendvotimin 1926E/01R, në Komunën e Prishtinës.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.970/2021, të ushtruar nga Besa Prestreshi nga Prishtina, kandidate për anëtare në Kuvend Komunal nga Lidhja Demokratike e Kosovës me numër të listës 45, me të cilin pretendon se në vendvotimet me numër 1926E-01R, 1930E-01D i mungojnë votat, në rastin konkret në vv.1926E/01R nuk i pasqyrohen fare votat në FRK(pra i ka zero vota), kurse në 1930E/01D, pasqyrohet vetëm 1 votë në FRK(janë më shumë se 1). Parashtruesja e apelit thekson se këto pretendime i dëshmon me provat e

bashkangjitura në këtë ankesë, që janë deklaratat e votuesve e me kopjet e tyre të letërnjoftimeve si dhe FRK. Andaj parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP që të aprovojë këtë ankesë dhe të urdhërojë KQZ-në që të hap këto 2 kuti/ vendvotime për ti rinumëruar votat dhe për ta korigjuar rezultatin final të tyre, ngase janë të gjitha elementet e provat që të bëhet përmisimi i rezultatit final në këto dy vendvotime.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, pas shqyrtimit të pretendimeve të apelit, materialit zgjedhor dhe provave që gjinden në shkresat e lëndëve, gjeti se:

Apeli është pjesërisht i bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Kandidatja për anëtare e Kuvendit Komunal të Prishtinës nga Lidhja Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, Besa Prestreshi, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në Vendvotimet 1926E-01R, 1930-01D, sa i përket numrit të votave për kandidat.

Paneli vlerëson se apeli është i bazuar sa i përket Vendvotimit, të vendosur si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, nga se rezulton se në Rezultatet përfundimtare nga KQZ, të Kandidatëve në vendvotimin e apeluar kandidatja për Kuvend Komunal Besa Pestreshi nga Subjekti Politik LDK, ka gjithsej 1 votë, ndërsa sipas deklaratës së votuesit të bashkangjitur në apel e që ndërlidhen me këtë VV, si dëshmi që deklaronë se ka votuar të njëjtin mirëpo këto vota nuk rezultojnë të jenë në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja, prandaj paneli konstaton se ka mospërputhje të rezultatit përfundimtar me deklarata të votueseve andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së e urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi..

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencën, efikasitetin, mundësinë për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur. Si në pikën II të dispozitivit.

Ndërsa sa i përket pikës -IV- të dispozitivit të vendimit, sipas se cilës është refuzuar pjesërisht apeli për rinumërim të Votave të VV 1926E-01R nga se pas verifikimit të të njëjtit VV, rezultoi se ky VV ishte rinumëruar nga KQZ.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 970/2021 më datën 07.11.2021.



Kryesues i Panelit

Burrin Ademi

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.